

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtares Mevlide Shabani, me sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. M. nga fshati Bresalc, Komuna Gjilan, të cilin e përfaqëson Bardhosh Dalipi, avokat nga Gjilani kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson juristi Arben Mehmeti nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensimin e të ardhurave personale me vlerë të përgjithshme të objektit të kontestit 2.869.56 € ( dymijetëqindëgjashtëdhjetenëntë euro e pesëdhjetëgjashtë cent), pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike të datës 15.05.2018, bie këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit M. M. nga fshati Bresalc, Komuna Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit t’ia paguaj 3 (tri) paga mujore si shpërblim jubilar në vlerë prej 1.434.78 € dhe 3 (tri) paga përcjellëse në vlerë prej 1.434.78 €, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme 2.869.56 €, me kamatë prej 8% nga data e përpilimit të këtij aktgjykimi e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj paditësit M. M. shumën e përgjithshme prej 260.20 € dhe atë për taksë gjyqësore shumën prej 21 €, për ndryshimin e padisë shumën prej 104 € dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 135.20 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

### 1.Kronologjia e çështjes

Paditësi M. M. nga fshati Bresalc, Komuna Gjilan, më datë 14.03.2016, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave personale dhe atë 3 (tri) paga mujore si shpërblim jubilar në vlerë prej 1.434.78 € dhe 3 (tri) paga përcjellëse në vlerë prej 1.434.78 €, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme 2.869.56 €, me kamatë prej 8% nga data e përpilimit të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje në padi, e paditura më datë 14.03.2017, ka paraqitur përgjigje në padi duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, ngase Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk prodhon efekte juridike edhe për komunën.

Gjykata më datë 14.09.2017 ka marr aktvendim për ndërprerjen e procedurës në afat prej 180 ditëve, si dhe ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Përfaqësuesi i paditësit, avokat Bardhosh Dalipi nga Gjilani me anë të parashtresës së datës 27.04.2018 ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv, ngase në fillim si e paditur ka qenë DKA në Gjilan, ndërsa me këtë parashtresë ka bërë ndryshimin duke e vendosur në pozitën e të paditurës Komunën e Gjilanit, ndërsa në kuptimin objektiv duke rregulluar shumën e kërkuar për kompensim të të ardhurave personale dhe atë 3 (tri) paga mujore si shpërblim jubilar në vlerë prej 1.434.78 € dhe 3 (tri) paga përcjellëse në vlerë prej 1.434.78 €, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme 2.869.56 €, me kamatë prej 8% nga data e përpilimit të këtij aktgjykimi ngase në padinë e parashtruar fillimisht kërkonte vetëm kompensimin e 3 pagave jubilarë dhe 3 të tjerave përcjellëse pa precizuar shumën e kërkuar..

Gjykata më datë 05.12.2017, 20.03.2018, 26.04.2018 dhe 15.05.2018 ka mbajtur seancat e shqyrtimit kryesor, në të cilat ishin prezent paditësi M. M., përfaqësuesit i tij me autorizim Bardhosh Dalipi, avokat nga Gjilani si dhe përfaqësuesi i të paditurës Komuna e Gjilanit, Arben Mehmeti, në të cilën është bërë edhe administrimi i provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse në seancën përgatitore si dhe është dhënë fjala përmbyllëse nga ana e tyre.

## 2.Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit M. M., avokat Bardhosh Dalipi nga Gjilani në shqyrtimin kryesor dhe fjalën përmbyllëse pas administrimit të provave ka deklaruar se është vërtetuar që paditësit nuk iu janë kompensuar 3 paga mujore si shpërblim jubilar si dhe 3 paga përcjellëse me rastin e pensionimit, me çrast ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të obligohet e paditura ta bëjë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse ndaj paditësit si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për taksë gjyqësore shumën prej 21 €, për ndryshimin e padisë shumën prej 104 € dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 135,20 € të gjitha këto në shumën prej 260.20 €.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës në shqyrtimin kryesor dhe fjalën përmbyllëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, ngase Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk prodhon efekte juridike edhe për komunën.

## 3.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor:

Në seancat e shqyrtimit kryesor janë administruar provat si në vijim: kontrata e punës në kohë të caktuar me numër 05 nr.262/13 e datës 01.09.2013, aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 05 nr.061-60946/2015 i datës 30.06.2015, i lëshuar nga DKA në Gjilan, vërtetimi i lëshuar nga SHFU “Ibrahim Uruqi”, në Bresalc, me numër 06/16 i datës 22.01.2016, përgjigjja në ankesë e lëshuar nga DKA në Gjilan, me numër

05-061-119564, e datës 05.01.2016, vërtetimi i lëshuar nga FMU “Ibrahim Uruqi”, në Bresalc, me numër 22/2018, i datës 27.03.2018 si dhe lista e pagave për muajin prill, maj dhe qershor të vitit 2015.

#### 4.Vlerësimet faktike dhe juridike te gjykatës:

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe provave të paraqitura, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike edhe atë:

Nga kontrata e punës në kohë të caktuar me numër 05 nr.262/13, e datës 01.09.2013, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M. M., më datë 01.09.2013 ka themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën në DKA në Gjilan për periudhë të caktuar dhe atë deri më datë 10.07.2015 në cilësinë e profesorit të gjeografisë në Shkollën Fillore “Ibrahim Uruqi”, në fshatin Bresalc, Komuna Gjilan.

Nga aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me numër 05 nr.061-60946/2015, i datës 30.06.2015, i lëshuar nga DKA në Gjilan , gjykata vërtetoi faktin se paditësit i ka përfunduar marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit-Pensionimit me rastin e arritjes së moshës 65 vjeçare.

Nga vërtetimi me numër 06/2016, të datës 22.01.2016, të lëshuar nga e Sh.F.U “Ibrahim Uruqi”, në fshatin Bresalc, Komuna Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka 34 vite e 10 muaj përvojë pune.

Nga përgjigjja në ankesë e lëshuar nga DKA në Gjilan, me numër 05-061-119564, e datës 05.01.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi para se t’i drejtohej gjykatës ka bërë kërkesë pranë të paditurës në mënyrë që e njëjta t’ia kompensojë pagat jubilarë si dhe pagën përcjellëse.

Nga lista e pagave për muajin prill, maj dhe qershor të vitit 2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësi deri në muajin qershor 2015 ka realizuar pagë të rregullt mujore nga ana e të paditurës dhe atë në vlerë prej 478.26 €.

Gjykata vendosi si në dispozitiv I të këtij aktgjykimi duke u bazuar në atë se në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, e përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 pika 1.3, të punësuarit për 30 vjet të përvojës së punës të pandërprerë i takojnë 3 (tri) paga mujore të tij, ndërsa në bazë të nenit 53 të po kësaj marrëveshje të punësuarit me rastin e pensionimit i takojnë 3 (tri) paga përcjellëse që i ka marrë në 3 muajt e fundit derisa ishte i punësuar, andaj edhe si të tillë gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit M. M. nga fshati B....., Komuna Gjilan, marrëveshja e lartcekur është në fuqi dhe krijon efekte juridike edhe për të paditurën. Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk obligon komunën që të bëjë kompensimin lidhur me pagat jubilarë si dhe ato përcjellëse, gjykata konsideron se ky pretendim nuk qëndron ngase marrëveshja e lartcekur është e nënshkruar nga ana e SBASHK-ut, Qeverisë së Kosovës, OEK, KES dhe AKB si institucionet kompetente për lidhjen e kësaj marrëveshje, ndërsa në bazë të

nenit 4 të kësaj marrëveshje *dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile, ndërsa në bazë të nenit 5 kjo marrëveshje vlen për të gjithë të punësuarit të cilët punojnë tek punëdhënësit, që kanë selinë në territorin e Kosovës.* Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi konform nenit 452 të LPK-së, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 260.20 € dhe atë për taksë gjyqësore shumën prej 21 €, për ndryshimin e padisë shumën prej 104 € dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 135,20 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Andaj gjykata bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lart, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën dhe se e paditura shumën përgjithshme prej 2.869.56 € nuk ia ka paguar atij, gjë të cilën është dashur ta bëjë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të hyrë në fuqi prej 01.01.2015.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.257/16, më datë 15.05.2018

**Sekretarja Juridike**  
Hyrije Sylejmani

**Gjyqtarja**  
Mevlide Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit, ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.